




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.32, datë 23.12.2024



PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SUBJEKTI “OSMANI” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Osmani” nëpërmjet hidrocentralit “Shënepremte”, në ujërat e përroit të Moçalit të Ariut dhe të Sharrës, degë të lumit Grabovë, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan”..
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Shënepremte

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Përroi Moçal Ariut

- X= 536732.2; Y= 4514561.1; Z=1713 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.3 m³/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.24 m³/s

- 
- Prurja ekologjike: $0.0275 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujq Përroi Sharrës

- $X=534951.1$; $Y=4513917.4$; $Z=1385 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja llogaritëse: $0.2 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.23 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.0225 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e veprës së marrjes 3/ burimi ujq Përroi Moçal Ariut

- $X=535089.8.1$; $Y=4514716$; $Z=1385 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja llogaritëse: $0.1 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.12 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.0113 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=533829.1$; $Y=4514228.8$; $Z=1150 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja që shkarkohet: $0.6 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: $7.130.483 \text{ kwh/vit}$
- Fuqia e instaluar: 1860 kwh
- Vlera totale e investimit: $266,731,236 \text{ lekë me TVSH}$.

Koordinatat e pikës së shkarkimit ku kanali i largimit të godinës së HEC-it, takon trupin ujq pritës:

- $X=533804.42$; $Y=4514212.49$; $Z=1148 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujtime dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

ARBEN ÇUKO

